



2 mars 2015

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut miratoi mendimin e tij për rastin *Kadri Balaj, Shaban Xheladini, Zenel Zeneli dhe Mustafë Nerjovaj kundër UNMIK-ut* (nr. 04/07)

Më 27 shkurt 2015, gjatë seancës së tij të 80-të të mbajtur në Prishtinë, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli) miratoi mendimin e tij lidhur me rastin *Balaj dhe të tjerët kundër UNMIK-ut*.

Ankesa e parashtruar nga ankuesit kishte të bënte me veprimet e Policisë së UNMIK-ut me rastin e një demonstrate të organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje, që u mbajt në Prishtinë, më 10 shkurt 2007. Si rezultat i këtyre veprimeve, z. Mon Balaj, djali i ankuesit të parë, dhe z. Arben Xheladini, djali i ankuesit të dytë, u vranë dhe demonstrues të tjerë u lënduan, disa prej tyre rëndë, duke përfshirë edhe z. Zenel Zenelin dhe z. Mustafë Nerjovajn, ankuesi i tretë dhe i katërt.

Ankuesit në thelb pohuan se vrasja e z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit dhe lëndimi i rëndë i shkaktuar z. Zenel Zenelit dhe z. Mustafë Nerjovajt, përbënin shkelje të së drejtës për jetë dhe të së drejtës për tubim paqësor. Ata po ashtu pohuan se nuk ka pasur hetim të efektshëm për këtë incident, duke rezultuar me shkelje të aspektit procedural të së drejtës për jetë. Dhe më në fund ata pohuan se, duke mos pasur mundësi të parashtronë ankesë kundër UNMIK-ut pranë një gjykate apo ndonjë organi tjetër ku do të kishin pasur mundësi të sigurojnë dëmshpërblim, janë shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe për mjet të efektshëm.

Paneli e shqyrtoi ankesën duke u bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nenet 2 (e drejta për jetë), 6 (e drejta për gjykim të drejtë), 11 (e drejta për tubim paqësor) dhe 13 (e drejta për mjet të efektshëm).

Paneli së pari gjeti se, në rrethanat e këtij rasti forca e përdorur për të shpërndarë demonstruesit, që shkaktoi vdekjen e z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit dhe lëndimet e z. Zenel Zenelit dhe z. Mustafë Nerjovajt, nuk ishte absolutisht e nevojshme në kuptim të nenit 2(2) të KEDNJ. Prandaj, Paneli gjeti se ka pasur shkelje të obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ.

Përveç kësaj, Paneli gjeti se, edhe pse hetimi i rrethanave që çuan në këto pasoja tragjike ishte i menjëhershëm, nuk paraqiti garanci të mjaftueshme të pavarësisë dhe paanshmërisë dhe nuk i përmbushi kërkesat për përpikëri. Kështu që, Paneli konsideroi se ka arsye bindëse për të dyshuar nëse hetimi ishte në gjendje të gjejë ata të cilët janë

përgjegjës dhe t'i sjellë para drejtësisë. Prandaj, Paneli nxori përfundimin se UNMIK-u nuk zbatoi hetim efektiv për këtë rast, duke shkelur obligimin procedural të nenit 2 të KEDNJ.

Lidhur me ankesat sipas nenit 6 dhe nenit 13 të KEDNJ se ankuesit nuk kanë pasur asnjë mjet në dispozicion dhe se nuk kanë pasur mënyra tjera të dëmshpërblimit, Paneli, duke marrë parasysh të gjeturat e tij lidhur me aspektin procedural të nenit 2 të KEDNJ dhe duke ditur se ankuesit ju drejtuan Procesit të ankesave nga palët e treta të KB-së, e konsideroi të panevojshme të shqyrtojë këtë pjesë të ankesës ndarazi.

Dhe së fundi, Paneli konstatoi se intervenimi me forcë i policëve ishte disproporcional dhe i panevojshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e trazirave duke shkelur nenin 11(2) të KEDNJ.

Paneli i rekomandoi UNMIK-ut publikisht të pranojë përgjegjësinë e tij lidhur me shkeljen e identifikuar në nenet 2 dhe 11 të KEDNJ dhe ankuesve t'u kërkojë falje publike lidhur me këtë, dhe të ndërmerr hapat e duhur për pagimin e kompensimit adekuat ankuesve për dëmin moral që ata kishin pësuar.

Paneli gjithashtu rekomandoi, në rast se hetimi për këtë çështje rihapet, që UNMIK-u të sigurojë ofrimin e gjithë ndihmës së nevojshme për cilindo autoritet që do të hetonte këtë rast, në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së 66/93, të miratuar më 9 dhjetor 2011, mbi përgjegjësinë penale të zyrtarëve dhe ekspertëve të Kombeve të Bashkuara në mision.

Paneli po ashtu e konsideroi të duhur që UNMIK-u të ndërmerr hapa pranë organeve kompetente të KB-së, duke përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së, për të siguruar që në të gjitha rastet e përdorimit të forcës në operacionet paqeruajtëse të KB-së, të gjithë pjesëtarët e Policisë civile të KB-së të veprojnë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe që standardet e përgjithshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mbështeten në çdo kohë nga Kombet e Bashkuara, duke përfshirë edhe kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive në një territor.

Teksti i mendimit aktualisht është në dispozicion vetëm në anglisht. Versionet në gjuhën shqipe dhe serbe do të jenë në dispozicion pasi të përkthehen.

Kjo komunikatë për shtyp është dokument i përgatitur nga Sekretaria e Panelit. Nuk është detyruese për Panelin. Për informacione shtesë, luteni të kontaktoni z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv i Sekretarisë së Panelit, përmes e-mail: antonov@un.org, tel: +381 (0)38 504 604 lokali 5847.

Paneli u krijua në Prishtinë nga UNMIK-u në vitin 2006, për të shqyrtuar ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut.

Vendimet, mendimet dhe informacione të tjera për Panelin mund të gjinden në uebfaqen e tij: www.unmikonline.org/hrap